



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Z.Anr.556/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë e Kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, Arianit Ibrahim, lagjja Malësia numër 25, rruga “Dëshmorët e Kombit” paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Kamenicë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale, me datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 31.10.2017, mori këtë:

#### V E N D I M

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, e Kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, Arianit Ibrahim, me shenjen ZL.Anr.556/2017 e datës 30.10.2017, e parashtruar kundër kryesuesve dhe komisionerëve në Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Kamenicë.

#### A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar një ankesë përmes dërgesës postare me datë 24.10.2017, e njëjta e evidentuar sipas protokollit me datën 30.10.2017, nga Arianit Ibrahim, Kandidat për Anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik LVV, me të cilën ka pretenduar se Kamenicë në vendvotimet VV 1032D, 1022D, 1001X, 1001X 03R, 1012D, 1003D, 1009D ka pasur pa rregullsi, prandaj PZAP-it i ka kërkuar rinumërimin e votave sepse kryesuesit dhe komisionarët kanë brë shkelje gjatë procesit zgjedhorë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e pa rregullt**

Paneli i PZAP-it, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë Arianit Ibrahim nga subjekti politik LVV është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga kandidati në fjalë dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson standartet e kërkuara sipas Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6 ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj Paneli, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara ligjore nga dispozita e lartëtheksuar.

Nga arsyet e sipërhënuara e në mbështetje të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015) dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.556/2017 më datën 31.10.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

Hasan Shala

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.